

20162024522

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM PËR EMETIMIN DHE KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË MONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 2 DENARË

1. Me këtë vendim përcaktohen karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale 2 denarë, të cilat emetohen nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

2. Monedhat me vlerë nominale 2 denarë janë të punuara nga çeliku i veshur me dy shtresa, ku shtresa e parë është e punuar nga bakri, ndërsa shtresa e dytë nga përzierja e bakrit dhe e zinkut.

3. Monedhat me vlerë nominale 2 denarë kanë diametër 25,50 mm, trashësi 1,80 mm dhe peshë 6,20 gr.

Për çdo monedhë lejohet devijim prej 0,05 mm mbi ose nën diametrin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, 0,08 mm mbi ose nën trashësinë e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe deri 0,40 gr mbi ose nën peshën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Skajet e monedhës janë të sheshtë.

4. Monedhat me vlerë nominale 2 denarë kanë këto karakteristika:

- Pamja e përparme: në mes me numër është shënuar numri "2", dhe nën te në hark është shënuar fjala "ДЕНАРИ" (DENARË). Në gjysmën e sipërme të parasë, në hark janë paraqitur gjashtëmbëdhjetë rreze në formë katër-këndore. Numri "2" shtrihet mbi rrezet.

- Pamja e pasme: në mes është e gravuar Trofta e Ohrit, dhe përreth saj në formë rrethore është shkruar "РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА" (REPUBLIKA E MAQEDONISË). Në pjesën e poshtme në hark është shkruar viti i farkëtimit "2017".

5. Monedhat me vlerë nominale 2 denarë të emetuara në pajtime me Vendimin për emetim, vlerë nominale dhe karakteristika themelore të monedhave dhe kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 25/93), mbeten edhe më tej në qarkullim.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr.V. 02-15/XII-3/2016
3 nëntor viti 2016
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov